
e-Filing

Udhëzuesi i Përdoruesit

Shërbimi: Deklarata Tatimi mbi Të

Ardhurat e Korporatës



Autorësia: ikubINFO
Krijuar më: Dhjetor2024

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje.....	3
Hyrje në sistem	3
Deklarata Tatimi Mbi Të Ardhurat e Korporatës	4
Periudha e Vlefshmërisë	5
Krijimi i Deklaratës Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatës.....	5
Shfaqja e deklaratës dhe shkarkimi i Udhëzuesit Deklarata “Tatim mbi të Ardhurat e Korporatës”	8
Data e pritshme e dorëzimit të Deklaratës Tatim mbi të Ardhurat e Korporatës	9
Plotësimi i rubrikave të deklaratës dhe validimi sipas rregullave.....	9
Ruajtja dhe dorëzimi	15
Krijimi i deklaratës model “Ndryshim nga tatimpaguesi”	16
Gjenerimi i urdhërpagesës.....	17
Gjoha për deklarim të vonuar	18
Gjoha dhe interesi për pagesë të vonuar të detyrimit	18

Tabela e Figurave

Figure 1. Hyrje në sistem	4
Figure 2. Menuja Tatim mbi të Ardhurat e Korporatës	6
Figure 3. Nën menutë e deklaratës Tatim mbi të Ardhurat e Korporatës	7
Figure 4. Nën menuja Deklarata të Padorëzuara.....	7
Figure 5. Nën menuja Deklarata të Dorëzuara	8
Figure 6. Detajet e Deklaratës.....	9
Figure 7. Data e pritshme e dorëzimit të deklaratës	9
Figure 8. Deklarata të padorëzuara	10
Figure 9. Fushat e editueshme, të paeditueshme	10
Figure 10. Të dhënat e tatimpaguesit deklarues	11
Figure 11. Seksioni Të Ardhurat	11
Figure 12. Seksioni Shpenzimet	12
Figure 13. Seksioni Humbje Fitim.....	13
Figure 14. Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat e korporatës	13
Figure 15 Llogaritja e Tatimit Mbi të Ardhurat e Korporatës	14
Figure 16. Llogaritja e Tatimit mbi të Ardhurat e Korporatës.....	14
Figure 17. Llogaritja e rubrikave të kreditimit	15
Figure 18. Llogaritja e tatimit për t'u paguar	15
Figure 19. Deklarata të dorëzuara	16

Figure 20. Krijimi i Modelit të deklaratës "Ndryshim nga Tatimpaguesi"	16
Figure 21. Plotësimi i rubrikave për modelin Ndryshim nga Tatimpaguesi	17
Figure 22. Gjenerimi i Urdhërpagesës	18

Hyrje

Ky manual shërben si udhëzues për të gjithë përdoruesit tatimpagues dhe përfaqësuesit të cilët kanë të drejtë të bëjnë dorëzimin e tatimeve në mënyrë elektronike. Çdo tatimpagues do të identifikohet në mënyrë unike në sistemin E-Filing po ashtu edhe në sistemin C@TS. Regjistrimi i Tatimpaguesit në sistem bëhet në sistemin bazë për subjektet ligjore dhe individët me shtetësi jo Shqiptare, ndërsa regjistrimi i individëve me shtetësi Shqiptare të cilët kanë të drejtë të dorëzojnë deklarin e tatimit mbi të ardhurat personale, bëhet në të dyja sistemet, në atë bazë dhe E-filing me anë të vetëregjistrimit. Një llogari tatimore krijohet për çdo tatimpagues në mënyrë të tillë që të zbulohen transaksionet financiare në nivel tatimpaguesish.

Hyrje në sistem

Çdo përdorues i sistemit duhet të marrë një ID-i (identifikim) dhe fjalëkalim të caktuar. Çdo hyrje e të dhënave dhe ndryshim regjistrohet në sistem. Kjo gjë siguron që çdo ndryshim i të dhënave gjurmohet në të ardhmen.

Çdo përdorues i cili ka nevojë të hyjë në sistem i shfaqet pamja e mëposhtme e sistemit.



Figure 1. Hyrje në sistem

Përdoruesi vendos një emër përdoruesi dhe fjalëkalimin përkatës. Gjuha e zgjedhur në këtë pamje do të jetë gjuha e përdorur për të shfaqur të gjitha format dhe të dhënat në sistem.

Në klikim të butonit "Hyr në Sistem" nis aplikimi.

Deklarata Tatimi Mbi Të Ardhurat e Korporatës

Nëpërmjet sistemit e-Filing tatimpaguesi deklaron dhe dorëzon deklaratën Tatim mbi të Ardhurat e Korporatës. Duke filluar nga Janari 2025 (25-A) tatimpaguesit e përkufizuar si Entitete, regjistrohen për përgjegjësinë e re tatimore kodi 2600, Tatimi mbi Të Ardhurat e Korporatës.

Si rrjedhojë e këtij ndryshimi atyre u mundësohet një formë e re deklarimi. Kjo deklaratë e re, Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatës, gjithashtu përmban rregulla validimi dhe llogaritje të cilat mundësojnë dorëzimin e saj sipas rregullave të implementuar për të shmangur cdo gabim të mundshëm njerëzor apo shmangie nga pagesa .

Njëkohësisht cdo funksionalitet ekzistues në sistem është përditësuar për të mundësuar si tatimpaguesit ashtu edhe përdoruesit e C@TS të realizojnë deklarin e rezultatit, kryerjen e pagesave përfshirë dhe kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor për përcaktimet e afateve dhe kontabilizimin e detyrimeve për dorëzim apo pagesë të vonuar të lidhura me këtë deklaratë.

Periudha e Vlefshmërisë

Do të përfundojë afati vlefshmërisë së deklaratës ekzistuese Tatim mbi Fitimin v3 me datë:
E vlefshme deri:31.12.2024

Deklarata e Tatimit mbi Fitimin,Protv3, do të vijojë të jetë e vlefshme për periudhat para datës 31.12.2024, për krijim , dorëzim, korrigjim, duke ruajtur të njëjtat rregulla për të mundësuar si tatimpaguesit ashtu dhe inspektorit veprimet me funksionalitetet e pershkruara në funksionin aktual.

Deklaratat e TF dhe TFTH nuk do të jenë të vlefshme për periudhat \geq 25-A.

Deklarata e Tatimit mbi të Ardhurat Koorporative, do të implementohet në përputhje me Formularin e miratuar pjesë e aneksit 4, të Udhëzimit nr.26, datë 08.09.2023.

Krijimi i Deklaratës Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatës

Deklarata Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatës për tatimpaguesit ekzistues krijohet automatikisht nga sistemi bazë në datën 1 Janar, ndërkohë që për tatimpaguesit e rregjistruar përgjatë vitit kalendarik krijohet nga proceset e serverit pas aprovimit të përgjegjësive tatimore përkatëse.

Deklarata e Tatimit mbi të Ardhurat e Korporatës e cila gjenerohet automatikisht nga sistemi C@TS mund të gjenden në e-Filing duke klikuar në menunë Deklarata, Tatim mbi të Ardhurat e Korporatës dhe duke përzgjedhur tabelën “Deklarata të Padorëzuara”.

Deklarata	Listëpagesat	Librat e Shitjeve dh
TVSH		
Tatim Fitimi		
Tatimi i Lojrave të Fatit		
Tatimi mbi të Ardhurat Personale		
Renta Minerare		
Renta Minerare e hidrokarbureve		
Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin		
Taksat Kombëtare		
Tarifat Kombëtare		
Tatimi i Mbatjur në Burim dhe të Ardhura të Tjera		
Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore		
Kontributet e Sigurimeve Shëndetësore		
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi		
Tatimi mbi të Ardhurat Personale të Biznesit të Vogël		
Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatës		
Tatimi mbi të ardhurat personale nga Biznesi		
Deklaratat e Mia të Padorëzuara		

Figure 2. Menuja Tatim mbi të Ardhurat e Korporatës

Cdo tatimpagues aktiv, i regjistruar për përgjegjësinë tatimore “Tatim mbi të Ardhurat e Korporatës” akseson këtë deklaratë në E-Filing së bashku me nënmenutë e saj:

- Deklarata të Padorëzuara
- Deklarata të Dorëzuara
- Deklarata të Refuzuara
- Deklarata të Arshivuara




Figure 3. Nën menutë e deklaratës Tatim mbi të Ardhurat e Korporatës

Nën menuja Deklarata të Padorëzuara shfaq të dhëna lidhur me:

- Periudha
- Data e krijimit
- Data e Pritshme e Deklaratës
- Detyrim i Deklaruar
- Kredia Tatimore
- Ndryshim
- Frekuenca e Dorëzimit




Figure 4. Nën menuja Deklarata të Padorëzuara

Nën menuja Deklarata të Dorëzuara shfaq të dhëna lidhur me:

- Periudha
- Data e krijimit
- Data e Pritshme e Deklaratës
- Data e Deklaratës
- Data e Plotësimit
- Data e Vlerësimit Alternativ

- Detyrim i Deklaruar
- Kredia Tatimore
- Modeli i Deklaratës
- Statusi i Deklaratës
- Frekuenca e Dorëzimit





Figure 5. Nën menuja Deklarata të Dorëzuara

Shfaqja e deklaratës dhe shkarkimi i Udhëzuesit Deklarata “Tatim mbi të Ardhurat e Korporatës”

Në nën menunë Deklarata të Padorëzuara, shfaqet deklarata me status krijuar, por e padorëzuar, bashkë me detajet e saj. Përdoruesi klikon mbi ikonën  për të parë detajet e deklaratës. Në fund të deklaratës janë dhe 3 butonat

[Kontrollo saktësinë e formës](#) [Ruaj](#) [Dorëzo](#)

Butoni “Kontrollo saktësinë e formës” shërben për të validuar fushat e plotësuara nëse janë në përputhje me rregullat e validimit të implementuara në sistem për këtë deklaratë.

Butoni “Ruaj” shërben për ruajtjen paraprake të deklaratës në status “Të padorëzuar” dhe tatimpaguesi do mund të kryejë ndryshime në të deri në klikimin e butonit “Dorëzo”.

Butoni “Dorëzo” shërben për dorëzimin final të deklaratës. Kjo deklaratë ruhet në modelin “Normal”.

Pas dorëzimit nga tatimpaguesi nëpërmjet butonit Dorëzo, deklarata shfaqet te nënmenuja “**Deklarata të dorëzuara**”, me statusin gati për procesim.

Gjithashtu Udhëzuesi i Deklaratës aksesohet dhe të shkarkohet/printohet me sukses duke klikuar mbi link “Shkarko Udhëzimet”.

Përdoruesi plotëson Deklaratën Tatim mbi të Ardhurat e Korporatës në E-Filing duke klikuar në menunë Deklarata à nën menunë Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatës.

Deklarata ndryshohet duke klikuar butonin  në tabelën Deklarata të Padorëzuara:




Figure 8. Deklarata të padorëzuara

Për çdo rubrikë të deklaratës zbatohen rregullat e kontrollit të saktësisë dhe të llogaritjes automatike. Disa fusha ndryshohen nga tatimpaguesi, disa janë vetëm të lexueshme.

Të gjitha fushat gri, llogariten automatikisht nga sistemi dhe nuk mund të ndryshohen nga përdoruesi. Fushat e bardha plotësohen nga përdoruesi, por mbi këto fusha aplikohen disa rregulla validimi.





Figure 9. Fushat e editueshme, të paeditueshme

Nëse përdoruesi klikon të ikonën , shfaqen rubrikat e deklaratës si mëposhtë:

Të dhënat e tatimpaguesit deklarues, popullohen automatikisht nga sistemi bazuar te të dhënat e regjistrimit të tatimpaguesit, nuk janë të editueshme nga ndërfaqja:

- Rubrika (2) - Periudha e deklaramit
- Rubrika (3) - Numri Identifikues i Personit të Tatuësëm (NIPT)
- Rubrika (4) - Emri tregtar i Personit të Tatuësëm,
- Rubrika (5) - Adresa: Qyteti/Komuna/Rrethi
- Rubrika (6) – Numri i Telefonit

Deklarata | Lidhjet | Libret e Shitjes dhe Blerjes | Kontaktilitet | ofring Im | Fëmishini | Aksion | Rreth ofring

Deklarata e Tatimit mbi të Ardhurat Korporatës Shkruaj shtet

Tatimpaguesi TatDOK Penuzha: 24-A

Numër Identifikues / Tatimpaguesit	Emri Tregtar / Personi në Takueshem	TatDOK
Zemër Mbledhje / Personi Publik	Adresa	Post e shprehur
Qyteti	Bashkia / Komuna	Transa
Rrethi	Numri / Telefoni	

Figure 10. Të dhënat e tatimpaguesit deklarues

Rubrika Të ardhurat dhe Shpenzimet

Në **Seksionin e të Ardhurave**, rubrikat janë të editueshme dhe pranojnë vlera pozitive:

(7/8) Të ardhura nga aktiviteti ekonomik kryesor

(9/10) Të ardhura nga aktivitete të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit

(11/12) Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse dhe ose dividenti

(13/14) Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata

(15/16) Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme

(17/18) Të ardhura të tjera

(19/20) Të ardhura Total – këto 2 rubrika janë të paeditueshme dhe përlllogarisin saktë sipas funksionit të implementuar totalin e rubrikave përkatëse:

Të ardhura total ushtrimore [19] = [7+9+11+13+15+17]

Të ardhura total ushtrimore [20] = [8+10+12+14+16+18+20]

Logaritja e Rezultatit		Të ushtrimor	Tatimore
Të ardhurat dhe shpenzimet			
(7/8) Të ardhura nga aktiviteti ekonomik kryesor		1,000	5,000
(9/10) Të ardhura nga aktivitete të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit		1,000	5,000
(11/12) Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse dhe ose dividenti		1,000	5,000
(13/14) Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata		5,000	1,000
(15/16) Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme		1,000	5,000
(17/18) Të ardhura të tjera		5,000	1,000
(19/20) Të ardhurat Total		14,000	22,000

Figure 11. Seksioni Të Ardhurat

Në **Seksionin e Shpenzimeve**, rubrikat janë të editueshme dhe pranojnë vlera pozitive:

(21/22) Kosto e mallrave, produkteve apo shërbimeve të shitura

(23/24) Shpenzime të punës (paga + sigurime shoqërore e shëndetësore)

(25/26) Shpenzime administrative

(27/28) Amortizimi

(29/30) Shpenzime interesi dhe shpenzime të tjera te ngjashme

(31/32) Shpenzime të tjera financiare

(33/34) Shpenzime të tjera

(35/36) Shpenzimet Total – këto 2 rubrika përmbajnë llogaritje automatike si shumatore e rubrikave që përfaqësojnë të ardhurat apo shpenzimet dhe vlera është e paeditueshme.

Shpenzimet ushtrimore [35] = [21+23+25+27+29+31+33]

Shpenzimet tatimore [36] = [22+24+26+28+30+32+34]

(21/22) Kinto e mallrave, prodimeve, apo shërbimesve të shitura	20,000	200,000
(23/24) Shpenzime të punës (paga + sigurime shpërndare e shëndetësore)	20,000	20,000
(25/26) Shpenzime administrative	1,000	1,000
(27/28) Amortizimi	10,000	10,000
(29/30) Shpenzime interesi dhe shpenzime të tjera te ngjashme	10,000	10,000
(31/32) Shpenzime të tjera financiare	10,000	10,000
(33/34) Shpenzime të tjera	10,000	10,000
(35/36) Shpenzimet Total	81,000	261,000
(37) Shpenzimet e pazbritshme		100,000

Figure 12. Seksioni Shpenzimet

Shpenzimet e pazbritshme

Rubrika (37) Shpenzimet e pazbritshme paraqitet e editueshme, lejon vlera pozitive por jo më e madhe sesa rubrika [36], Totali i shpenzimeve.

Nëse përdoruesi plotëson vlerë më të lartë, ajo përditësohet automatikisht sipas rregullit e barabartë me rubrikën [36].

Llogaritja e rezultatit: Humbje Fitim

Rubrikat: (38/39) Humbja, shfaqen të paeditueshme dhe llogarisin vlerën :

Humbja ushtrimore (38) = (35)-(19) kur (35)>(19)

Humbja Tatimore (39) = (36)-(37)-(20) kur (36)-(37)> (20)

Rubrikat (40/41) Fitimi, shfaqen të paeditueshme dhe llogarisin vlerën :

Fitimi Ushtrimor (40) = (19)-(35) kur (19)>(35)

Fitimi Tatimor (41) = (20)+(37)-(36) kur (20)+(37)>(36)

Humbja e mbartur:

Rubrika [42], është e editueshme, merr vlera positive, më e vogël ose e barabartë me Fitimin [41].

Për vlera > se [41], sistemi do të përditësojë automatikisht shumën e plotësuar = (41).

Fitim i tatueshëm:

Rubrika [43] llogaritet automatikisht dhe nuk është e editueshme

[43] = [41]Fitim- [42]Humbje e mbartur,

Kur [42] =0, atëherë [43]=[41]

Kur [42] = [41], atëherë [43]=0

Kur [42]< [41], atëherë [43]= [41-42] , ku vlera do të jetë pozitive.

Rezultati	
(28/39) Humbje (38) = (35)-(19) kur (35)>(19) (39) = (36)-(37)-(20) kur (36)-(37)>(20)	67.000 143.000
(40/41) Fitim (40) = (19)-(35) kur (19)>(35) (41) = (20)-(37)-(36) kur (20)-(37)>(36)	0 0
(42) Humbje e mbartur	0
(43) Fitimi i tatueshëm (43)=(41)-(42)	0

Figure 13. Seksioni Humbje Fitim

Tatimi mbi të ardhurat e korporatës:

- Kur rubrika [20] <=14.000.000(proporcionale), [43]>0, Shenjuesi përcakto vlera të tjera, nuk është i vendosur, atëherë:

Rubrika [44] = [43] dhe është e paeditueshme.

Rubrika [45] = [44] x 0% , llogaritet automatikisht dhe është e paeditueshme

Rubrikat [46],[47],[48],[49], janë të pandryshueshme =0

Rubrika [50] = [45] =0

(13/14) Interesi të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme	15.000	15.000
(17/18) Të ardhura të tjera	10.000	10.000.000
(19/20) Të ardhurat Total	240.000	10.140.000
(21/22) Kosto e mallrave, produkteve, apo shërbimeve të shitura	200.000	200.000
(23/24) Shpenzimet të punës (page + sigurime shpirtërore e shëndetësore)	15.000	100.000
(25/26) Shpenzime administrative	100.000	100.000
(27/28) Amortizimi	100.000	10.000
(29/30) Shpenzime interesi dhe shpenzime të tjera të ngjashme	20.000	200.000
(31/32) Shpenzime të tjera financiare	100.000	100.000
(33/34) Shpenzime të tjera	100.000	100.000
(35/36) Shpenzimet Total	630.000	810.000
(37) Shpenzimet e paditueshme		200.000
Rezultati		
(28/39) Humbje (38) = (35)-(19) kur (35)>(19) (39) = (36)-(37)-(20) kur (36)-(37)>(20)	390.000	0
(40/41) Fitim (40) = (19)-(35) kur (19)>(35) (41) = (20)-(37)-(36) kur (20)-(37)>(36)	0	9.520.000
(42) Humbje e mbartur		10.000
(43) Fitimi i tatueshëm (43)=(41)-(42)		9.520.000
Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat e korporatës		
(44/45) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore standarde 15%	9.520.000	0
(46/47) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore standarde 2%	0	0
(48/49) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore të tjera	0	0
(50) Totali i tatimit		0

Figure 14. Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat e korporatës

- Kur rubrika [20] > 14.000.000 (proporcionale) atëherë:

Rubrika [45] = [44] x 15% llogaritet automatikisht dhe është e paeditueshme

Rubrikat [46],[47],[48],[49], janë të pandryshueshme =0

Rubrika [50]=[45]

(19/20) Te ardhurat Total	240,000	100,140,000
(21/22) Kosta e mallrave, produkteve, apo shërbimeve të shitura	200,000	200,000
(23/24) Shpenzime të punës (paga + sigurime shqiptore e shëndetësore)	10,000	100,000
(25/26) Shpenzime administrative	100,000	100,000
(27/28) Amortizimi	100,000	10,000
(29/30) Shpenzime interesi dhe shpenzime të tjera të regjistruara	20,000	200,000
(31/32) Shpenzime të tjera financiare	100,000	100,000
(33/34) Shpenzime të tjera	100,000	100,000
(35/36) Shpenzimet Total	630,000	810,000
(37) Shpenzimet e paidentifikuara		200,000
Rezultati		
(38/39) Humbja (38) = (25)-(19) kur (25)<(19) (39) = (36)-(37)-(20) kur (36)-(37)>(20)	390,000	0
(40/41) Fitimi (40) = (19)-(25) kur (19)>(25) (41) = (20)+(37)-(36) kur (20)>(37)>(36)	0	99,520,000
(42) Humbje e mbartur		10,000
(43) Fitimi i tatueshëm (43)=(41)-(42)		99,520,000
<input type="checkbox"/> Përcakto vlerat për kutitë (44), (46), (48)		
Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat e korporatës	 baza e Tatueshme	 Tatimi
(44/45) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore standarde 15%	99,520,000	14,928,000
(46/47) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore standarde 5%	0	0
(48/49) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore të tjera	0	0
(50) Totali i tatimit		14,928,000

Figure 15 Llogaritja e Tatimit Mbi të Ardhurat e Korporatës

- Tatimi me norma të ndryshme nga norma standarde 15%, sistemi lejon vendosjen e shenjuesit ■ Përcakto vlerat për kutitë (44), (46), (48) :

Rubrikat [44], [46], [48] janë të editueshme >=0

Rubrikat [45], [47] kryejnë llogaritjet automatike

$$[45] = [44] * 15\%$$

$$[47] = [44] * 5\%$$

$$[49] = e \text{ editueshme } >=0$$

Rubrika [50] = Totali i rubrikave [45+47+49], automatike dhe e paeditueshme

(19/20) Te ardhurat Total	240,000	100,140,000
(21/22) Kosta e mallrave, produkteve, apo shërbimeve të shitura	200,000	200,000
(23/24) Shpenzime të punës (paga + sigurime shqiptore e shëndetësore)	10,000	100,000
(25/26) Shpenzime administrative	100,000	100,000
(27/28) Amortizimi	100,000	10,000
(29/30) Shpenzime interesi dhe shpenzime të tjera të regjistruara	20,000	200,000
(31/32) Shpenzime të tjera financiare	100,000	100,000
(33/34) Shpenzime të tjera	100,000	100,000
(35/36) Shpenzimet Total	630,000	810,000
(37) Shpenzimet e paidentifikuara		200,000
Rezultati		
(38/39) Humbja (38) = (25)-(19) kur (25)<(19) (39) = (36)-(37)-(20) kur (36)-(37)>(20)	390,000	0
(40/41) Fitimi (40) = (19)-(25) kur (19)>(25) (41) = (20)+(37)-(36) kur (20)>(37)>(36)	0	99,520,000
(42) Humbje e mbartur		10,000
(43) Fitimi i tatueshëm (43)=(41)-(42)		99,520,000
<input checked="" type="checkbox"/> Përcakto vlerat për kutitë (44), (46), (48)		
Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat e korporatës	 baza e Tatueshme	 Tatimi
(44/45) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore standarde 15%	20,000	3,000
(46/47) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore standarde 5%	10,000	500
(48/49) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore të tjera	20,000	0
(50) Totali i tatimit		3,500

Figure 16. Llogaritja e Tatimit mbi të Ardhurat e Korporatës

Llogaritjet dhe rregullat per kreditim:

Rubrikat për kreditim të tatimit nuk mund të plotësohen me vlerë >[50].

Rubrika [51] Kreditimi i tatimit të huaj : është e editueshme, vlera >0, vlera<=50, sistemi përditëson automatikisht vlerën kur ajo vendoset nga përdoruesi >[50]

Rubrika [52] Kreditimi i tatimit të mbajtur në burim, është e editueshme, vlera >0, vlera<=50, sistemi përditëson automatikisht vlerën kur ajo vendoset nga përdoruesi >[50]

Rubrika [53] Tatimi mbi të ardhurat e korporatës i shtyrë, është e editueshme, vlera >0, vlera<=50, sistemi përditëson automatikisht vlerën kur ajo vendoset nga përdoruesi >[50]



(50) Totali i tatimit	3,500
(51) Kreditimi i tatimit të huaj	100
(52) Kreditimi i tatimit të mbajtur në burim	1,000
(53) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës i shtyrë	1,000

Figure 17. Llogaritja e rubrikave të kreditimit

Nëse përdoruesit plotësojnë rubrikat [51], [52], [53] me vlera positive që janë më të mëdha se vlera e rubrikës [50], atëherë sistemi gjate validimit nuk do të lejojë dorëzimin e deklaratës. Do të shfaqet mesazhi i gabimit sipas rregullave të vlefshmërisë në krye të deklaratës.


Ka gabime validimi.

- Keni vlerë negative tek kutitë Box054
- Shuma e kutive 51,52,53 nuk mund ta kalojë vlerën e kutis 50

Tatimi për t'u paguar:

Rubrika (54) Tatim mbi të ardhurat e korporatës i detyrueshëm për t'u paguar = [50]-[51]-[52]-[53]

Nëse rubrikat [51], [52], [53] plotësohen me vlerën 0, atëherë rubrika [54]=[50]



(51) Kreditimi i tatimit të huaj	1,000
(52) Kreditimi i tatimit të mbajtur në burim	1,000
(53) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës i shtyrë	1,000
(54) Tatim mbi të ardhurat e korporatës i detyrueshëm për t'u paguar (54) = (51)-(52)-(53)	300

Figure 18. Llogaritja e tatimit për t'u paguar

Ruajtja dhe dorëzimi

Në momentin që janë plotësuar të gjitha rubrikat e deklaratës, përdoruesi klikon butonin

Kontrollo saktësinë e formës

për të parë që rubrikat përmbushin rregullat e validimit dhe nuk ka gabime në

plotësim. Nëpërmjet klikimit të butonave **Ruaj** **Dorëzo** bëhet ruajtja dhe dorëzimi i deklaratës.

Deklarata e dorëzuar shfaqet në nën menunë Deklarata të dorëzuara në eFiling. Deklarata mund të

përzgjidhet me simbolin e shigjetës dhe të printohet me butonin **Printo**.




Figure 19. Deklarata të dorëzuara

Krijimi i deklaratës model “Ndryshim nga tatimpaguesi”


Pas dorëzimit të deklaratës model Normal, tatimpaguesi mund të kryejë nga eFiling ndryshime të saj deri në 36 muaj (3 vite kalendarike)

Për tatimpaguesit që kanë dorëzuar deklaratën “Tatim mbi të Ardhurat e Korporatës”, të modelit “Normal”, mund të regjistrohet deklarata “Ndryshim nga Tatimpaguesi” si dhe ndiqen rregullat e validimit për të njësoj si për modelin “Normal” të deklaratës. Për të kryer këtë proces ndiqen hapat si më poshtë:

- ❖ Tatimpaguesi klikon mbi menunë Deklarata
- ❖ Tatimpaguesi klikon nën menunë “Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatës”
- ❖ Tatimpaguesi klikon mbi nën menunë “Deklarata të Dorëzuara”
- ❖ Tatimpaguesi klikon mbi rekordin e deklaratës “Tatim mbi të Ardhurat e Korporatës” e regjistruar
- ❖ Tatimpaguesi klikon butonin Ndryshim Deklarate
- ❖ Tatimpaguesi plotëson ndryshimet e deklaratës po me të njëjtat rregulla validimi si në deklaratën model "Normal"
- ❖ Tatimpaguesi klikon butonin Dorëzo



Figure 20. Krijimi i Modelit të deklaratës "Ndryshim nga Tatimpaguesi"



Periudha	Kodi i Niv. Ardhurat nga Korporatë	Urdhërpagesa Tatimore	Llogji i Gjithë nga Detyrimet	Detyrimi i Pajisur	Gjithë e Pajisur	Interesi i Pajisur	Totali i Shumës së Pajisur	Numeri
23-A, 2023 Janar-Dhjetor	260000	2600, Tatimi mbi të ardhurat e Korporatës	10,000	0	0	10,000		1

Figure 22. Gjenerimi i Urdhërpagesës

Formati i Urdhërpagesës që gjenerohet nga sistemi përmban elementët nevojshëm. Seriali i Urdhërpagesës Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatës gjenerohet sipas formatit: NIPT260000periudha tatimore.

Detajet e urdhërpagesës përfshijnë sipas rregullit të detajuar: principalin, gjobën për pagesë të vonuar dhe interesin.

Gjopa për deklarim të vonuar

Për tatimpaguesit të cilët dorëzojnë në sistem deklaratën Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatës pas datës së pritshme të dorëzimit 31.03. xxxx ose që kanë deklarata me status të padorëzuar, gjenerohet gjopa me vlerë 10.000 lekë.

Për tatimpaguesit me përgjegjësi tatimore Tatimit mbi të Ardhurat nga Biznesi, përfshirë dhe ata tatimpagues të cilët nuk kanë të vlefshme asnjë nga përgjegjësitë Tatimi mbi të Ardhurat nga Korporata dhe Tatimi mbi të Ardhurat nga Biznesi (trup diplomatik, kryefamiljare, ambulante etc), të cilët dorëzojnë në sistem deklaratën ESIG025v3 pas datës së pritshme të dorëzimit ose që kanë deklarata me status të padorëzuar, gjenerohet gjopa me vlerë 5.000 lekë.

Gjopa dhe interesi për pagesë të vonuar të detyrimit

Për tatimpaguesit me përgjegjësi tatimore Tatimit mbi të Ardhurat e Korporatës, të cilët kryejnë pagesë të vonuar, pra data e pritshme e pagesës është më e madhe se data e pritshme e detyrimit, gjenerohet gjopa dhe interesi për pagesë të vonuar sipas kodeve të të ardhurave të lidhura me këtë deklaratë.